



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 149, Datë 10.06.2022

MBI

**KËRKESËN PËR LICENCIMI TË SHOQËRISË “SALILLARI ENERGY TRADE”  
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 866/12 prot., datë 02.06.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 90, datë 28.04.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5- vjeçar.
- ERE me shkresën nr. 70/15 prot., datë 29.04.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 16.05.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 469/2 prot., datë 06.05.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Salillari Energy Trade” sh.p.k. me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 469/5 prot., datë 20.05.2022 dhe nr 495/6 prot., datë 24.05.2022, ka përcjellë në ERE dokumentacion dhe informacionin shtesë.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë për furnizimin e energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të Aneksit A të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”*, e ndryshuar.
- Në mbështetje të nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, me qëllim dokumentimin dhe depozitimin në ERE të vërtetimit të prokurorisë për administratorin e saj dhe dokumentacionin që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, vlerësohet e arsyeshme që shoqëria *“Salillari Energy Trade”* sh.p.k. të paraqesë në ERE jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pune dokumentat e kërkuara në përputhje me rregulloren në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Shoqëria *“Salillari Energy Trade”* sh.p.k të paraqesë jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pune dokumentat e kërkuara në përputhje me rregulloren në fuqi.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.